



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

**V E N D I M**

Nr. 11, datë 27.04.2018

**P Ë R**

**MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “RIKONSTRUKSIONI DHE SHTESË ANËSORE NË AMBJENTET E GODINËS CIVILE TË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, BASHKIA TIRANË”**

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rikonstruksioni dhe shtesë anësore në ambjentet e godinës civile të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Bashkia Tiranë”, me subjekt zhvillues Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**EDI RAMA**

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I DREJTËSISË

ETILDA GJONAJ



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LËDIA TOTA

